



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODOVOD I OTPAD
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



Politika Tarifore

për Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe për Ujëra të Zeza

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina

16 Mars 2011

Misioni

“Ofrimi i shërbimeve kualitative, efikase dhe të qëndrueshme, për të gjithë konsumatorët në Kosovë nga ana e kompanive regjionale të ujit dhe mbeturinave të ngurta të licencuara nga ZRRUM.”

Vizioni

“Rregullimi i sektorëve të ujit dhe mbeturinave të ngurta me anë të metodave transparente dhe të drejta në pajtim me praktikën e mirë europiane e cila garanton sigurimin e shërbimeve kualitative, të qëndrueshme, të pranueshme dhe të sigurta nga ana e kompanive të ujit dhe mbeturinave të ngurta kudo në Kosovë, duke respektuar mjedisin dhe shëndetin publik”

Politika Tarifore për Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe për Ujëra të Zeza

Shkurt 2011

(Draft 06)

Përmbajtja

1.	HYRJE.....	1
1.1	Dispozitat e përcaktimit të tarifave bazohen në Ligjin Nr. 03/L-086, dhe Rregulloren e ZRRUM-it (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/49).....	1
1.2	Objektivat	1
2.	JURISDIKSIONI	1
2.1	Ofruesitë e shërbimeve	1
3.	OPCIONET KRYESORE TË POLITIKËS TARIFORE	2
3.1	Drejhtësia shoqërore dhe strukturat e tarifave	2
3.1.1	<i>Roli i ofruesve të shërbimeve lidhur me përgjegjësinë sociale</i>	<i>2</i>
3.1.2	<i>Furnizimi me ujë dhe shërbimet për ujërat e zeza – tarifa të ndara</i>	<i>2</i>
3.1.3	<i>Strukturat e tarifave</i>	<i>2</i>
3.1.4	<i>Unifikimi i tarifave</i>	<i>3</i>
3.1.5	<i>Grupet e konsumatorëve</i>	<i>3</i>
3.1.6	<i>Bllok-tarifat dhe tarifat bazike</i>	<i>3</i>
3.1.7	<i>Tarifat mujore fikse</i>	<i>4</i>
3.1.8	<i>Tarifat mujore fikse për konsumatorët që kanë qasje vetëm në shërbimin e ujërave të zeza</i>	<i>4</i>
3.2	Nivelet e shërbimit.....	4
3.3	Zgjerimi i zonës së shërbimeve	4
3.3.1	<i>Taksat e kyçjes</i>	<i>4</i>
3.3.2	<i>Taksat për zhvillimin e infrastrukturës.....</i>	<i>5</i>
3.4	Konsideratat për kujdesin mjedisorë	5
3.4.1	<i>Kontrolli mbi shfrytëzimin e ujit.....</i>	<i>5</i>
3.4.2	<i>Taksat për marrjen e ujit.....</i>	<i>6</i>
3.4.3	<i>Menaxhimi i humbjeve të ujit</i>	<i>6</i>
3.4.4	<i>Përputhja me standardet e mjedisit.....</i>	<i>6</i>
3.4.5	<i>Koncepti-ndotësi paguan.....</i>	<i>6</i>
3.5	Mbulimi i kostos.....	7
3.5.1	<i>Përkufizimi</i>	<i>7</i>
3.5.2	<i>Koha e duhur për arritjen e mbulimit të plotë të kostos.....</i>	<i>7</i>
3.5.3	<i>Pritjet e efijencës</i>	<i>7</i>
3.5.4	<i>Mbulimi i kostos kapitale të investimeve.....</i>	<i>8</i>
3.6	Struktura e kapitalit, vlera dhe kthimi i kapitalit	8
3.6.1	<i>Struktura e kapitalit</i>	<i>8</i>
3.6.2	<i>Baza Rregullatore e Aseteve</i>	<i>8</i>
3.6.3	<i>Kapitali i punës.....</i>	<i>9</i>
3.6.4	<i>Kthimi në kapital</i>	<i>9</i>
3.6.5	<i>Procesi i vënies së taksave.....</i>	<i>9</i>
3.7	Rishikimet e mëdha tarifore dhe rregullimet e përkoshme	9

1. HYRJE

1.1 Dispozitat e përcaktimit të tarifave bazohen në Ligjin Nr. 03/L-086, dhe Rregulloren e ZRRUM-it (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/49)

Kjo politikë i referohet Ligjit Nr. 03/L-086 dhe Rregullorës ZRRUM (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/49) të cilës në vijim i referohemi vetëm si 'Ligj'.

Kjo politikë e lëshuar nga Zyra Rregullatore për Ujësjetës dhe Mbeturina (ZRRUM), paraqet interpretimin dhe elaborimin e obligimeve ligjore, lidhur me tarifat e rregulluara për shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza.

Veçanërisht, sipas Nenit 38 të Ligjit të ZRRUM-it (*Rregullat e lëshuara nga Rregullatori*) kërkohet që ZRRUM-i të krijojë rregulla për vendosjen dhe aprovimin e tarifave. Kjo politikë është bazë mbi të cilën vendosen rregullat e tilla të detajizuara.

Neni 10 i Ligjit të ZRRUM-it përshkruan obligimet e caktuara të vënies së tarifave duke përfshirë:

- Procesin e konsultimit (10.2)
- Pritjet e efiçencës (10.3 b)
- Taksat e kyçjes që përmbushen nga konsumatorët (10.3 c)
- Mjaftueshmërinë për përmbushjen e kostove kapitale dhe kostove tjera (10.3 d)
- Harmonizimin e tarifave (10.3 e)

Obligimet ligjore, siç janë paraparë në Ligjin e ZRRUM-it, lejojnë një shkallë të diskrecionit rregullativ të bazuar në gjykimin profesional, kuptimin e entiteteve të rregulluara (dhe rrethanave specifike të tyre) dhe kriterin socio-ekonomik.

1.2 Objektivat

Interesat e palëve të ndryshme nuk përputhen domosdo; për shembull interesat e konsumatorit për çmimet e ulëta janë kontradiktore me interesat e investitorëve në qëndrueshmërinë financiare. Është detyrë e ZRRUM-it të sigurojë që çmimet të japin një balancim optimal në mes të këtyre interesave dhe vlerë më të mirë të mundshme duke përfshirë çmimin dhe kualitetin e përmirësuar të shërbimit për shoqërinë. Kjo politikë tarifore është përpiluar në atë mënyrë që të sigurojë balancimin më të mirë të përgjithshëm.

2. JURISDIKSIONI

2.1 Ofruesit e shërbimeve

Ky dokument i politikave është i bazuar në mjedisin aktual institucional ku ndërmarrjet publike të ujit në shtatë regjione janë ofruesit e vetëm të shërbimeve urbane të ujit dhe shërbimeve për ujëra të zeza, që funksionojnë mbi bazën e monopoleve lokale. Tarifat për shërbimet e ujit me shumicë që ofrohen sektorëve të energjisë dhe atyre bujqësore nga NPH 'Ibër Lepenci', si dhe disa ndërmarrjeve publike të ujit, janë të adresuara në një deklaratë shtesë për politika.

Juridiksioni fizik i zonave të shërbimit të ofruesve të shërbimit nuk është statik dhe mund të kërkojë përshtatje për të marrë parasysh zonat e reja komunale të inkorporuara në zonat e furnizimit të ofruesve të shërbimit.

DPFUUZ 1: Jurisdiksioni

Kjo politikë e tarifave zbatohet për aktivitetet e shtatë Kompanive Regjionale për furnizim me ujë dhe ofrimin e shërbimit të ujërave të zeza (KRU). Nuk zbatohet për shërbimet e ujit me shumicë të ofruara nga NPH 'Ibër Lepenci'.

Kjo politikë tarifore pranon faktin se juridiksionet fizike të ofruesve të shërbimeve janë subjekt i ndryshimit të kohë pas kohshme dhe prandaj ndikimet duhet të akomodohen në procesin e përcaktimit të tarifave.

3. OPCIONET KRYESORE TË POLITIKËS TARIFORE

3.1 Drejtësia shoqërore dhe strukturat e tarifave

3.1.1 Roli i ofruesve të shërbimeve lidhur me përgjegjësinë sociale

Ligji 03/L-086 (Neni 10.3.) potencon se tarifat duhet të përcaktohen në përputhje me rregullat e nxjerra nga Rregullatori, ndërsa pika e nenit 10.3. (f) përkufizon se është përgjegjësi e Institucioneve Shtetërore të Republikës së Kosovës, jo e ofruesve të shërbimeve, për tu ndihmuar konsumatorëve me të ardhura të ulëta, që ti paguajnë faturat e tyre. Si pasojë e kësaj, ofruesit e shërbimeve duhet të lejohen që të operojnë në baza të plota komerciale.

DPFUUZ 2: Përgjegjësia sociale

Qeveria (lokale dhe qendore) është përgjegjëse për përmbushjen e nevojave të të varfërve, duke përfshirë ndihmën për kryerjen e shpenzimeve të shërbimeve publike.

3.1.2 Furnizimi me ujë dhe shërbimet për ujërat e zeza – tarifa të ndara

Tarifat për furnizimin me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza duhet të përcaktohen veçmas dhe nuk duhet të ketë ndër-subvencionim në mes të këtyre dy shërbimeve. Pra, kostot dhe të ardhurat për këto dy shërbime duhet të regjistrohen veçmas, ashtu siç është përcaktuar në Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator, për përcaktimin e tarifave dhe për qëllime të monitorimit rregullator.

DPFUUZ 3: Furnizimi me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza janë aktivitete të veçanta të biznesit.

Tarifat për furnizim me ujë dhe për shërbimet e ujërave të zeza do të përcaktohen në bazë të aktiviteteve të veçanta të biznesit dhe nuk do të ketë ndër-subvencionim në mes të këtyre dy aktiviteteve.

3.1.3 Strukturat e tarifave

Tarifat për furnizimin me ujë përbëhen nga tarifa fikse dhe tarifa volumetrike, bazuar mbi konsumin e matur të furnizimit me ujë. Konsumatorët të cilët nuk pranojnë shërbime të ujërave të zeza nuk duhet të ngarkohen për shërbimet në fjalë. Tarifat për shërbimet e ujërave të zeza do të përcaktohen në bazë të vëllimit të shitur, përveç kur një konsumatorë është i kyçur në rrjetin e ujërave të zeza, por jo edhe në rrjetin e furnizimit me ujë (ose ka një burim shtesë të vetin të furnizimit me ujë), e në të cilin rast do të aplikohet ngarkesa e bazuar në gjenerimin e vlerësuar apo të matur të ujërave të zeza. Në të ardhmen tarifat për ujërat e zeza mund të përfshijnë dispozita për cilësinë e efluentit të gjeneruar, përmes formulës Mogden ose ekuivalentit të saj.

DPFUUZ 4: Strukturat tarifore të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të zeza

Tarifat për furnizim me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza do të përcaktohen në bazë të volumit të shitur të ujit, përpos nëse shfrytëzuesi i shërbimeve të ujërave të zeza furnizohet vetë me ujë, e në të cilin rast do të aplikohen ngarkesa bazuar në gjenerimin e vlerësuar të ujërave të zeza. Konsumatorët të cilët nuk pranojnë shërbime të ujërave të zeza, nuk duhet të ngarkohen për shërbimet në fjalë.

3.1.4 Unifikimi i tarifave

Edhe pse kostot e shërbimeve përbrenda zonës së shërbimit të një ofruesi të shërbimeve ka të ngjarë të ndryshojnë sipas sistemit dhe qytetit, nuk është praktike (pa sistemet e ndërlikuara të kontabilitetit) të përcaktohen tarifa të veçanta për secilën zonë. Si pasojë e kësaj, tarifat duhet të jenë uniforme në të gjithë zonën e mbuluar me shërbime nga ofruesi i shërbimit. Nëse megjithatë adoptohet një zonë e re ose një komunë e re nga ofruesi i shërbimit, që ka një tarifë aktuale më të ulët se tarifa aktuale e ofruesit të shërbimit, rregullimi i tarifës së ofruesit të shërbimit mund të ketë nevojë të shpërndahet gjatë disa viteve, e kjo për të shmangur çmimet befasuese.

DPFUUZ 5: Unifikimi i tarifave

Tarifat duhet të jenë uniforme në të gjithë zonën e shërbimit të ofruesve të shërbimit, përpos në rastet kur zona të reja të shërbimit janë adoptuar nga ofruesi i shërbimit dhe tarifat duhet të ngriten për t'i unisuar tarifat aktuale të ofruesit të shërbimit, e në të cilin rast do të ishte e përshtatshme një rritje progresive (jo më shumë se gjatë tre viteve).

3.1.5 Grupet e konsumatorëve

Kostot sipas njësive mund të dallojnë tek grupet e ndryshme të konsumatorëve, p.sh. kosto për njësi të furnizimit për numrin e madh të konsumatorëve industrial mund të jetë dukshëm më i ulët se sa të konsumatorëve shtëpiak. Në anën tjetër, konsumatorët shtëpiak mund të kenë pengesa të përballeshmërisë me të cilat nuk janë sprovuar konsumatorët jo-shtëpiak. Kjo politikë tarifore pranon se në afat të shkurtë pengesat e përballeshmërisë mund të kenë përparësi mbi eficiencën ekonomike. Qasja e tanishme është imponimi i tarifave më të larta për konsumatorët jo-shtëpiak sesa për konsumatorët shtëpiak. Ky ndër-subvencionim duhet të përfundojë me kalimin e kohës dhe duhet të pasqyrohet një reduktim gradual i shkallës së ndër-subvencionimit, në shqyrtimin e tarifave shumë-vjeçare. Megjithatë, ky reduktim, në instancën e parë do të zbatohet vetëm për shërbimet e furnizimit me ujë dhe jo për ujërat e zeza (shih DPFUUZ 17: Koncepti i pagesës nga ndotësi)

DPFUUZ 6: Grupet e Konsumatorëve

Në afat të shkurtër, tarifat për shërbimet e furnizimit me ujë duhet të caktohen në bazë të asaj që konsumatorët jo-shtëpiak do të paguajnë tarifë më të lartë se konsumatorët shtëpiak. Ky ndër-subvencionim duhet të përfundojë me kalimin e kohës dhe duhet të pasqyrohet një reduktim gradual në procesin e shqyrtimit të tarifave shumë-vjeçare. Megjithatë, kjo qasje nuk aplikohet për shërbimet e ujërave të zeza.

3.1.6 Bllok-tarifat dhe tarifat bazike

Edhe pse ka argumentime sociale lidhur me tarifën bazike, d.m.th. tarifa e ulur për vëllimin e ujit që është e nevojshëm për nevoja bazike, ekzistojnë edhe shumë pengesa ekonomike dhe praktike të strukturave të tarifave, sidomos sa i përket jo praktikitetit të aplikimit të sistemit të tillë në apartamente që kanë

kyçje individuale. Kështu që koncepti i bllok-tarifave dhe tarifave bazike nuk përkrahet nga ZRRUM-i dhe struktura aktuale e tarifave volumetrike uniforme duhet të mbetet.

DPFUUZ 7: Bllok-tarifat dhe tarifat bazike

Struktura e tarifave duhet të jetë uniforme sipas sistemit aktual

3.1.7 Tarifat mujore fikse

Struktura aktuale tarifore lejon për një kombinim të tarifave fikse dhe volumetrike. ZRRUM beson se ky sistem duhet të mbetet. Duke e pasur parasysh se ndër-subvencionimi për tarifat volumetrike do të reduktohet me kalimin e kohës, ndër-subvencionimi për elementin e tarifave fikse poashtu duhet të reduktohet në përputhje me rrethanat.

DPFUUZ 8: Tarifat mujore fikse

Ofruesitë e shërbimeve duhet të kenë të drejtën e imponimit të tarifës fikse mujore por, vlera duhet të kufizohet në jo më shumë se shpenzimet e aktiviteteve të shërbimit të konsumatorëve, p.sh. leximi i ujëmatësit, zëvendësimi i ujëmatësit dhe faturimi. Çdo ndër-subvencionim në tarifat fikse nga konsumatorët jo-shtëpiak te ata shtëpiak, duhet të përfundojë në të njëjtin nivel që kanë përfunduar edhe ndër-subvencionimet tjera.

3.1.8 Tarifat mujore fikse për konsumatorët që kanë qasje vetëm në shërbimin e ujërave të zeza

Tarifat fikse në përgjithësi zbatohen për shërbimin e furnizimit me ujë, përveç kur konsumatori e ka burimin e vet të furnizimit me ujë por është duke përdorur shërbimin e ujërave të zeza, e ku tarifa fikse duhet të aplikohet edhe nëse konsumatori nuk ka blerë ujë nga ofruesi i shërbimit.

DPFUUZ 9: Tarifat mujore fikse

Konsumatorët që shërbehen vetëm me shërbimin e ujërave të zeza do të jenë subjekt i tarifave mujore fikse.

3.2 Nivelet e shërbimit

Dihet që niveli i shërbimeve në shumë zona është nën nivelet e pranueshme minimale (standartet BE ose të ngjajshme). Është e diskutueshme çështja që konsumatorët të cilët pranojnë nivel të ulët të shërbimeve, duhet të paguajnë tarifën e ulët sipas njësisë, sesa ata të cilët pranojnë nivel të lartë të shërbimeve. Sidoqoftë, nuk është praktikë e mirë që tarifat të vendosen mbi këtë bazë dhe mekanizmat kompensuese alternative do të zbatoheshin më mirë.

DPFUUZ 10: Nivelet e shërbimit

Tarifat nuk duhet të ndryshojnë sipas nivelit të shërbimit. Sidoqoftë, ZRRUM-i duhet të përdorë fuqitë e tij rregullatore për të përmbushur standartet minimale të kualitetit dhe të shërbimeve.

3.3 Zgjerimi i zonës së shërbimeve

3.3.1 Taksat e kyçjes

Struktura e tanishme tarifore për taksat e kyçjes lejon mbulimin e shpenzimit të bërë për kyçjen nga lidhja kryesore deri te konsumatori. Pozicioni i ZRRUM-it është që taksa e tillë duhet të mbetet.

Vini re, taksa është e pagueshme vetëm në lidhje me një konsumatorë individual dhe jo për një grup të konsumatorëve. Në disa raste ofruesit e shërbimeve kanë imponuar një taksë të kyçjes në një kompani ndërtimi për sigurimin e shërbimeve për banesa të shumta dhe pastaj kanë vendosur një taksë tjetër për secilën banesë. Kjo praktikë nuk është qëllimi i taksës së kyçjes dhe duhet të imponohet vetëm për banesat individuale dhe jo për ndërtuesin për lidhjen e bllokut në tërësi.

DPFUUZ 11: Taksat e kyçjes

Ofruesitë e shërbimeve mund të aplikojnë taksat e kyçjes (veq e veq për shërbimet e furnizimit me ujë dhe ujëra të zeza) si dhe mbulimin e shpenzimeve të gypave, valvulave, ujëmatësit, orëve të punës etj. si dhe shpenzimet administrative siç edhe përdoret tani. Taksat e tilla mund të paguhen nga agjencitë donatore për rastet sociale.

Tarifat e kyçjes janë të zbatueshme vetëm për konsumatorin e fundit dhe jo për ata ndërmjetës për konsumatorët e shumtë.

3.3.2 Taksat për zhvillimin e infrastrukturës

Zgjerimi i shërbimeve (ujë dhe ujëra të zeza) paraqet kërkesa shtesë të infrastrukturës për ofruesitë e shërbimeve, p.sh. zgjerimi i rrjetit, pajisjet e pompimit etj. Një pjesë e madhe e kërkesës për zgjerimin e shërbimit të furnizimit me ujë shtesë i atribuohet blloqeve të reja të apartamenteve dhe kërkesave tregtare/industriale. Në rastin e blloqeve të banimit ato janë të financuara nga ndërtuesit në vend se prej pronarëve individual. Prandaj është e ditur se imponimi i taksave për zhvillim infrastrukturor ndaj kompanive të ndërtimit dhe ndërmarrjeve të reja tregtare/industriale është e drejtë dhe e arsyeshme. Megjithatë është e ditur se në terma afat-shurtër mekanizmat institucional nuk janë ende në vend sa i përket imponimit të taksave për zhvillim infrastrukturor dhe se rishikimi i ardhshëm i tarifave (2012-2014) nuk do të përfshijë dispozitat për taksat e zhvillimit infrastrukturor dhe si i tillë zgjerimi infrastrukturor duhet të përfshihet në tarifat për furnizim me ujë dhe shërbimet për ujëra të zeza.

DPFUUZ 12: Taksat për zhvillim të infrastrukturës

Ofruesitë e shërbimeve duhet të imponojnë tarifat për zhvillimin e infrastrukturës në ndërtimet e reja për të mbuluar shpenzimet e zgjerimit të shërbimeve me qëllim që t'i përmbush kërkesat e rritura të ujit. Vlera e taksës duhet të jetë e barabartë me shpenzimet marginale afatgjata të investimeve të nevojshme kapitale të llogaritura në bazë të numrit të banesave ose në rast që lidhen me ato komerciale/industriale, shumës së përcaktuar në bazë të kërkesës së pritshme.

Në periudhë afat-shkurtër, dhe përderisa të jetë themeluar korniza institucionale e nevojshme për këto taksa, nuk duhet të ketë taksë të zhvillimit infrastrukturor dhe zgjerimi infrastrukturor duhet të përfshihet në tarifat e furnizimit me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza.

3.4 Konsideratat për kujdesin mjedisorë

3.4.1 Kontrolli mbi shfrytëzimin e ujit

Nuk është as praktike dhe as e përshtatshme që në afat të shkurtër kohor të imponohen strukturat tarifore të menaxhimit të kërkesës (tarifat për konsumin e lartë të vendosura në nivelin e lartë për të penguar konsumin e tepruar). Në të ardhmën, ZRRUM-i mund të lejojë strukturat tarifore të menaxhimit të kërkesës

bazuar në evidencat shkencore të kufizimeve të burimeve të ujit. Zbatimi i strukturave e tilla duhet të jetë i tillë që ofruesit e shërbimeve nuk duhet të përfitojnë prej profitit të tyre.

DPFUUZ 13: Strukturat e tarifave të menaxhimit të kërkesës

Tarifat e menaxhimit të kërkesës nuk duhet përdorur në një afat të shkurtër, edhe pse ato mund të miratohen në një afat më të gjatë si subjekt për përfitime ekonomike bazuar mbi provat shkencore.

3.4.2 Taksat për marrjen e ujit

Aktualisht, ofruesit e shërbimeve paguajnë taksa për marrjen e ujit të papërpunuar. ZRRUM-i e përkrah imponimin e taksave të tilla duke pasur parasysh përmbushjen e kostos ekonomike të ujit dhe stimulimin e reduktimit të humbjeve të ujit.

DPFUUZ 14: Taksat për marrjen e ujit të papërpunuar

Imponimi i taksave për marrjen e ujit të papërpunuar është i përkrahur nga ZRRUM-i.

3.4.3 Menaxhimi i humbjeve të ujit

Pavarësisht nga komplikimet e vlerësimeve të shpenzimeve dhe përfitimeve të kontrollit të humbjeve të ujit, ZRRUM-i përkrah konceptin e zvogëlimit të rrjedhjeve deri në nivelin e tij ekonomik, d.m.th. ku shpenzimet e reduktimit të mëtejshëm të rrjedhjeve i tejkalojnë përfitimet. Sidoqoftë, në afat të shkurtër, është e njohur që nivelet e rrjedhjeve, duke u bazuar në gjykimin shkencor dhe në krahasim me industritë efektive të furnizimit me ujë kudo në botë, janë të mira në tejkalimin e niveleve të tyre ekonomike dhe që reduktimet duhet të jenë të arritshme dhe ekonomikisht të suksesshme.

DPFUUZ 15: Menaxhimi i humbjeve të ujit

Në periudhë afatshkurtër, ZRRUM-i duhet të vendos caqe për nivelet e shërbimeve dhe ujin e pa-faturuar edhe pse në afat të mesëm dhe afatgjatë, caqet duhet të jenë "niveli ekonomik i rrjedhjeve". ZRRUM-i duhet të monitorojë aktivitetet kontrolluese të humbjeve për të siguruar që humbjet mbahen në nivelin ekonomik dhe të mirren parasysh në strukturën e tarifave. Metodologjia e përcaktimit të tarifave duhet në mënyrë të kujdesshme të konsiderojë bilancin në mes të shpenzimeve të krijimit të burimeve të reja të ujit dhe shpenzimeve të kontrollit të humbjeve.

3.4.4 Përputhja me standardet e mjedisit

Nuk është praktikë të kërkohej nga ofruesit e shërbimeve të jenë në përputhje të plotë me standardet të BE dhe Kosovës, mbi mbrojtjen e mjedisit. Qasja në faza në arritjen e përputhshmërisë me standardet është konsideruar më e përshtatshme. Koha për përputhjen me standardet dhe çfarëdo standarde të përkohshme nuk përcaktohet nga ZRRUM-i, por është përgjegjësi e Qeverisë.

DPFUUZ 16: Pajtueshmëria me standardet e mjedisit

Përputhja me obligimet e mjedisit të bëhet në pajtueshmëri me afatin kohor të përcaktuar nga qeveria gjatë së cilës kohë kompanitë mund të ndër marrin investime të nevojshme dhe kostot të përfshihen në tarifa në mënyrë graduale gjatë investimeve të tilla.

3.4.5 Koncepti-ndotësi paguan

Politika tarifore mbështet konceptin ndotësi paguan dhe ofron tarifa më të larta për konsumatorët jo-shtëpiak, që konsiderohet se gjenerojnë efluentë që janë

më ndotës se ujërat e zeza të amvisërive, p.sh. nivele më të larta të derdhjeve të materieve të ngurta dhe nevojës biokimike për oksigjen (NBO). Në bazë të asaj që konsumatorët jo-shtëpiak kanë më shumë gjasa për të gjeneruar efluent ndotës, ka një arsye për të ngarkuar ata me një tarifë më të lartë se konsumatorët shtëpiak. Pasi të jenë zhvilluar objektet e trajtimit dhe të jenë përcaktuar saktë kostot e trajtimit, kjo shtesë mund të vlerësohet në mënyrën e duhur. Prandaj, dallimi në mes të tarifave për ujëra të zeza për konsumatorët jo-shtëpiak dhe ata shtëpiak, nuk duhet të konsiderohet si një ndër-subvencionim dhe duhet të mbetet si i tillë.

Në periudhë afatgjate politika tarifore duhet të ndryshohet në një qasje më të sofistikuar përmes aplikimit të formulës Mogden (ku ngarkesat për ujëra të zeza janë të bazuara në kombinimin e cilësisë së ujërave të zeza dhe volumit të gjeneruar të ujërave të zeza), e me këtë promovohet trajtimi në vend nga gjeneruesit e efluentit.

DPFUUZ 17: Koncepti-ndotësi paguan

Bazuar në arsyetimin se efluentët nga konsumatorët jo-shtëpiak në përgjithësi janë më ndotëse sesa ujërat e zeza të konsumatorëve shtëpiak, tarifat për ujërat e zeza për konsumatorët jo-shtëpiak do të caktohen në një nivel më të lartë se sa për konsumatorët shtëpiak. Në plan afat-gjatë tarifat e ujërave të zeza për konsumatorët jo-shtëpiak mund të përcaktohen në bazë të formulës Mogden.

3.5 Mbulimi i kostos

3.5.1 Përkufizimi

Mbulimi i kostos definohet në mënyra dhe forma të ndryshme. ZRRUM-i konsideron që mbulimi i kostos duhet të jetë i mjaftueshëm për Ndërmarrjet Publike, për t'i financuar aktivitetet e tyre dhe të fitojnë kthimin në kapital që kanë investuar. Metodologjia e detajuar do t'i vendos mekanizmat për përcaktimin e tarifave të cilët mund të arrijnë këtë qëllim përmes krijimit të udhëzuesve rregullator të kontabilitetit. Kjo përfshinë adoptimin e konceptit të kthimit në Bazën Rregullatore të Aseteve (BRA).

DPFUUZ 18: Përkufizimi i mbulimit të kostos

Mbulimi i kostos definohet si nivel i të hyrave të mjaftueshme për të financuar aktivitetet e tyre, plus kthimin e arsyeshëm në kapital që është investuar por ende ofrohen shërbime në pajtim me kërkesat e tyre ligjore dhe rregullative.

3.5.2 Koha e duhur për arritjen e mbulimit të plotë të kostos

Me përcaktimin fillestar të BRA, mund të bëhet kthimi në kapital i asaj pjese, duke e ngritur BRA me investimet e reja, ku poashtu do të ndodh edhe kthimi i asaj pjese të kapitalit të investuar.

DPFUUZ 19: Afati kohor për arritjen e mbulimit të kostos

Mbulimi i kostos duhet menjëherë të arrihet në mënyrë efektive duke qenë i mjaftueshëm për financimin e aktiviteteve të ofruesve të shërbimeve por kthimi në kapital duhet të rritet vazhdimisht me ndërmarrjen e investimeve të reja në sektor.

3.5.3 Pritjet e efijencës

Tarifat duhet të reflektojnë pritjet reale por, megjithatë sfiduese të efijencës së përmirësuar të ofruesve të shërbimeve, posaçërisht performancën e përmirësuar të arkëtimit dhe reduktimit të Ujit të Pa Faturuar (UPF). Pritjet do të

përcaktohen në Planet e Biznesit të ofruesve të shërbimit në mbështetje të aplikimit tarifor dhe duhet të jenë subjekt i shqyrtimit të ZRRUM.

DPFUUZ 20: Pritjet e përmirësimit të eficiencës

Ofruesit e shërbimeve do të paraqesin në Planet e Biznesit të tyre bashkë me detajet e aplikimit tarifor tre vjeçar të dhënat e tyre të propozuara për pritjet e përmirësimit të eficiencës. Këto plane do t'i nënshtrohen shqyrtimit dhe aprovimit të ZRRUM. Monitorimi i rregullt i performancës kundrejt pritjeve mbi eficiencën të përcaktuara në këto plane do të përbëjnë aspektin kryesor të aktiviteteve monitoruese të ZRRUM.

3.5.4 Mbulimi i kostos kapitale të investimeve

Qasja rregullatore për mbulimin e investimeve kapitale përfshinë disa metodologji të cilat janë përshkruar në detaje në Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullatorë (UKRR):

- Amortizimi nuk duhet të aplikohet në grantet e financuara apo asetet e dhuruara;
- Investimet e reja për përmirësimin e shërbimeve duhet të përfshihen në vlerën kapitale rregullatore por amortizimi duhet të ngarkohet vetëm për asetet jo-infrastrukturore (mbitokësore) përderisa nuk duhet të ngarkohet amortizimi për asetet nëntokësore dhe vlerat e tyre duhet të jenë afatgjate;
- Mirëmbajtja kapitale (riparimi dhe zëvendësimi) e infrastrukturës duhet të konsiderohet si shpenzim me të cilat ngarkohen tarifat, bazuar në planet infrastrukturore të menaxhimit të aseteve;
- Aty ku amortizimi është i ngarkuar (asetet jo-infrastrukturore) do të llogaritet në bazë të kostos aktuale, e cila për thjeshtësi do të bazohet në koston historike të përshtatur përmes një formule të thjeshtë të indeksimit të inflacionit të shitjes me pakicë.

DPFUUZ 21: Mbulimi i kostove kapitale të investimeve

Investimet kapitale të bëra nga ofruesit e shërbimeve duhet të kthehen me anë të aplikimit të Udhëzimeve Rregullatore të Kontabilitetit ku mirëmbajtja e kapitalit të infrastrukturës konsiderohet si shpenzim ndërsa shpenzimet e amortizimit aplikohen në asetet jo-infrastrukturore. Amortizimi në rastet kur merret në konsideratë, duhet të aplikohet vetëm në ato asete të financuara nga ofruesit e shërbimeve.

3.6 Struktura e kapitalit, vlera dhe kthimi i kapitalit

3.6.1 Struktura e kapitalit

Teoria ekonomike konvencionale tregon se struktura e kapitalit nuk ka kurfarë ndikimi në performancën e biznesit dhe si e tillë është çështje e menaxhimit të kompanive, e jo çështje rregullatore. Si rezultat i kësaj kthimi në kapital duhet të bazohet në kthimin në BRA.

DPFUUZ 22: Struktura e kapitalit

Struktura e kapitalit (kombinim i ekuitetit dhe borxhit) e ofruesve të shërbimeve nuk duhet të ketë asnjë ndikim në përcaktimin e tarifave e kjo në mënyrë që kthimi i dhënë në kapital do të jetë kthimi në BRA pavarësisht se si janë financiar asetet (me përjashtim të granteve dhe aseteve të dhuruara të cilat nuk janë të përfshira në BRA).

3.6.2 Baza Rregullatore e Aseteve

Baza Rregullatore e Aseteve (BRA) është e definuar si vlerë e aseteve mbi të cilat mund të fitohet një kthim. BRA do të përcaktohet si vlerë fillestare e përcaktuar në rishikimin tarifor 2009-2011, plus të gjitha investimet e

mëvonshme pa amortizim, të përshtatura në vlerën aktuale të kostos në përputhje me parimet aktuale të kontabilitetit mbi koston.

DPFUUZ 23: Baza Rregullatore e Aseteve (BRA)

BRA do të definohet si vlerë fillestare plus të gjitha investimet e reja neto (pas amortizimit) të përshtatura në vlerat aktuale të kostos.

3.6.3 Kapitali i punës

Kërkesat e kapitalit të punës të ofruesve të shërbimeve duhet të konsiderohen se janë të përfshira në BRA fillestar. ZRRUM merr pozitën që menaxhimi i kapitalit të punës është më tepër çështje menaxheriale se një çështje rregullatore. Rrjedhimisht, çdo ndryshim në kapitalin e punës nuk do të rezultojë në rregullimet e BRA.

DPFUUZ 24: Kapitali i Punës

Kapitali i punës i ofruesve të shërbimit është i përfshirë në BRA fillestar. Ndryshimet në kapitalin e punës nuk do të rezultojnë në rregullimet e BRA.

3.6.4 Kthimi në kapital

Ofruesit e shërbimeve duhet të kenë të drejtën për kthimin e drejtë në BRA. Norma e kthimit duhet të përcaktohet në bazë të kthimit me rrezikun e caktuar përmes aplikimit të Modelit Tarifor të Aseteve Kapitale (MTAK) ose ngjashëm. Në mungesë të të dhënave të duhura të tregut, ZRRUM-i mund të përdorë të dhëna zëvendësuese, p.sh. kostoja e kapitalit në tregun financiar të Kosovës e rregulluar për të reflektuar kategorinë e rrezikut të industrisë së ujit, ose kostot kapitale të tregjeve të tjera financiare të cilat aplikohen në vendet e BE-së, ose ato të vendeve të tjera.

DPFUUZ 25: Kthimi në kapital

ZRRUM-i duhet të përcaktoj kthimin e duhur në vlerën rregullatore të kapitalit të ofruesve të shërbimit bazuar në kushtet e tregut financiar në Kosovë, ose eventualisht të tregjeve të tjera financiare.

3.6.5 Procesi i vënies së taksave

Kthimi në kapital duhet të përcaktohet në bazën 'para-tatimore'. Tatimi në profitë do të konsiderohet që të jetë i përfshirë në kthimin në kapital. Tatimet e tjera të pa-kompensueshme, p.sh. TVSH në faturat e papaguara, duhet të përfshihen si një kosto në kërkesat për të hyra dhe të përfshihet në tarifë.

DPFUUZ 26: Procesi i vënies së taksave

Kthimi në kapital duhet të përcaktohet në bazë të parimit të bazës së 'para-tatimit'. Tatimet tjera të pakompensueshme duhet të përfshihen në tarifa.

3.7 Rishikimet e mëdha tarifore dhe rregullimet e përkoshme

Në përputhje me Ligjin 03/L-086 neni 10.5 ZRRUM duhet të rishqyrtojë tarifat çdo vit ose 'në çdo kohë tjetër kur kjo çështje është e rregulluar në marrëveshje më Ofruesin e Shërbimit...ku specifikohet kjo çështje'. ZRRUM duhet të përcaktojë tarifa tre-vjeçare me rishqyrtimin vjetor intervenues të përcaktuara me rregullore dhe i kufizuar për rregullimet e inflacionit dhe ngjarje tjera të jashtë-zakonshme.

Procesi shumë-vjeçarë (tre-vjeçarë) që ka filluar më rishikimin 2009-2011, duhet të vazhdojë mbi këtë bazë.

DPFUUZ 27: Rishikimet e mëdha tarifore

Rishikimet tarifore duhet të ndërmerren çdo tre vjet me rregullime të përkohshme të lejuara vetëm për normën e inflacionit, përpos nëse rrethanat ndërrojnë aq shumë sa kërkohet një rishikim i përkohshëm. Rrethanat e mjaftueshme për të shkaktuar një rishikim të përkohshëm duhet të përcaktohen në një shënim të veçantë udhëzues nga ZRRUM.

Sqarimet për shkurtesë;

DPFUUZ (Deklarata e Politikës së Furnizimit me Ujë dhe Ujëra të Zeza)

WSWWPS (Water Supply and Wastewater Policy Statement)